³¹ Radni dokument radnog osoblja Komisije: Izveštaj o Kosovu 2018, Strazbur, jul 2018, str. 6.

- Granične vlasti na Kosovu ne prihvataju pasoše koje izdaje Koordinaciona uprava a koji su važeći za međunarodna putovanja, ovo se ne zasniva ni na jednom postojećem zakonodavstvu i kako izgleda ograničava slobodu kretanja;
- Neuspeh kosovske vlade da uspostavi potpuno operativnu službu civilnog registra na severu³² koji ima institucionalni kapacitet da osigura integraciju i registraciju kosovskih Srba u svoj institucionalni okvir;
- Činjenica da su kancelarije civilnog registra na severu Kosova delimično ili nisu operativne

Pre avgusta 2018 godine³³, institucije i upravni organi na Kosovu nisu (u praksi, ali ne i na osnovu zakona) prihvatili lična dokumenta izdata od strane mekih "paralelnih" institucija kao dokaz boravka i / ili prava na državljanstvo. Kao što je navedeno u izveštaju NVO AKTIV koje donosi dodatne informacije date Evropskoj uniji u junu 2018 godine: *Izgleda da je jedno potencijalno opravdanje ili osnova za to bila usmena izjava koju je dala Edita Tahiri 2016 godine*³⁴³⁵ u kojoj je izjavila da su svi dokumenti izdati za Srbe koji žive na Kosovu bili ilegalni. Uprkos tome, nije bilo zvaničnog zakona ili administrativnog uputstva i / ili instrukcija koja bi navela ili odobrila ovu praksu. Ovo je još uvek praksa koja je prisutna u sprovođenju svojih aktivnosti od strane kosovskih vlasti, posebno od strane graničnih i carinskih službenika, a to je da ne prihvataju pasoše ili lična dokumenta izdata od strane Koordinacione uprave Vlade Srbije, kao važeća dokumenta za međunarodna putovanja. Poreklo ove prakse je opet ne određeno, ali ipak služi da ozbiljno ometa slobodu kretanja onih koji su time pogođeni. Ovo je, u samoj suštini, pitanje vladavine prava i dobre vladavine u meri u kojoj ona odražava nepravilne institucionalne prakse koje su dovele do toga da značajan deo zajednice kosovskih Srba ne pribegava dobijanju državljanstva i / ili ostalu potrebnu dokumentaciju da bi se mogli slobodno kretati.

³² <https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/106075-CPR-2018-En.PDF>

³³ Kada je Ministarstvo unutrašnjih poslova izdalo naredbu da kosovske institucije prihvate dokumente koje su izdale srpske institucije na **Kosovu** kao dokaz boravka

³⁴ <http://prishtinainsight.com/kosovo-bans-usage-serbian-parallel-id-cards/>

³⁵ <http://prishtinainsight.com/documented-yet-invalid-mag/>

II. Nedavna dešavanja

- Ministarstvo unutrašnjih poslova Kosova je 2016 godine donelo odluku koja je olakšala zamenu srpskih vozačkih dozvola izdatih između juna 1999 i septembra 2016 za kosovskim. Do kraja 2017 godine obrađeno je 3.668 prijava.³⁶
- Ministarstvo unutrašnjih poslova izdalo je uputstva pod nazivom Uputstvo o kriterijumima koji sadrže dokaze o državljanstvu SRJ i stalnom boravku na teritoriji Kosova 1. januara 1998 godine. Iako se tražili da se razjasni određeni broj postupaka u procesu podnošenja zahteva za državljanstvo Kosova, nisu naveli da li su dokumenti koje su izdale paralelne institucije pravno valjani radi korišćenja u svrhu dokazivanja neprekidnog boravka na teritoriji Kosova
- U julu 2018. godine, Ministarstvo unutrašnjih poslova izdalo je **administrativnu naredbu** u kojoj se navodi da "svi građani Kosova" mogu da se prijave za akte registracije civilnog statusa (izvod rođenja, izvod venčanih i umrlicu) koristeći dokumenta koja su izdale "srpske strukture" na Kosovu³⁷

Iako su neke od ovih promena bile pozitivne prirode, gore navedena naredba je stupila na snagu u leto 2018 godine i njeno važenje prestaje 2019 godine. Pored toga, ovom naredbom se samo prihvataju dokumenta koja su izdata do 2016 godine (u toj naredbi nije dato nikakvo obrazloženje). Do sada, malo je toga što bi se moglo reći da je ovo značajno poboljšalo situaciju za one Srbe koji su imali poteškoće u pristupu dokumentima o državljanstvu, jer je ova naredba sačinjena sa određenim stepenom tajnosti, a do sada nije učinjen nikakav napor od strane kosovske vlade da upozna građane među kosovskim Srbima ili drugim pogođenim nevećinskim zajednicama u vezi ove promene. Bilo je reči o tome da postoji određeni broj anegdotskih dokaza sugerise da se naređenje sprovodi u opštini Severna Mitrovica.

Preporuke:

1. Ministarstvo unutrašnjih poslova Kosova bi trebalo da obnovi administrativnu naredbu (br.296) onda kada ona istekne u julu 2019. godine i razjasni odredbe koje dozvoljavaju prihvatanje dokumenata koje izdaju srpske "strukture" na Kosovu;

³⁶ <https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/106075-CPR-2018-En.PDF>

³⁷ Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, Naredba Br. 296/2018, 05/07/2018

2. Administrativno uputstvo kojim se nalaže da kosovske granične vlasti priznaju valjanost pasoša izdatih od strane Koordinacione Uprave, čime se omogućava nesmetana i nepovrediva sloboda kretanja u regionu za one koji ih poseduju;
3. Potrebno je pokrenuti sveobuhvatnu informativnu kampanju kako bi se stanovnici bolje informisali i komuniciralo se o njihovim institucionalnim pravima kada je reč o pristupu za dobijanje državljanstva i druga lična dokumenta - takva kampanja bi poslužila da se ojača veza između građana, vladinih institucija kao i sa mehanizmima koji im služe za zaštitu od administrativnih opstrukcija i diskriminacije. Čak šta više, to bi povećalo ukupan kvalitet i obim informacija koje su javno dostupne;
4. Sveobuhvatni program obuke usmeren na zaposlene u javnom sektoru koji su zaduženi za rešavanje zahteva za izdavanje državljanstva kako bi povećali svoje razumevanje njihovih zakonskih obaveza, kao i dubinu i kvalitet njihovog poznavanja relevantnih procedura;

Kvote za manjine

I. Kontekst i opis problema

Promovisanje ravnopravnog učešća svih zajednica u organizaciji i vođenju javnih službi jedan je od najvažnijih elemenata u promociji i zaštiti prava zajednica.

Svrha ovih analiza je da pruži pregled pravnog okvira koji reguliše zastupljenost manjinskih zajednica u javnim službama na Kosovu i da proceni trenutni status zastupljenosti zajednica u državnim službama uopšte.

Štaviše, ovaj izveštaj analizira raspoložive podatke u odnosu na zakonske odredbe u skladu sa važećim zakonodavstvom na Kosovu, kako bi se procenilo da li je zastupljenost manjinskih zajednica ispunjena i na centralnom i na opštinskom nivou, kako bi se utvrdilo u kojoj meri su javne institucije koje vrše upošljavanje su uskladile njihove zakonske obaveze prema važećim zakonskim propisima u pogledu davanja podrške i povećaju zastupljenost zajednica u državnoj službi na Kosovu.

Kosovsko zakonodavstvo

Ustav Kosova u Poglavlju III (Prava zajednica i njihovih članova) predviđa da zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu zastupljenost u zapošljavanju u javnim organima i javnim preduzećima na svim nivoima, uključujući posebno u policijskoj službi u oblastima u kojima žive zajednice, uz poštovanje pravila koja se odnose na kompetentnost i integritet onih koji upravljaju javnom upravom.³⁸

Osim toga, Zakon o civilnoj službi navodi da sve zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u državnoj službi u institucijama na centralnom i lokalnom nivou, na osnovu principa nediskriminacije, jednakih mogućnosti i jednake zastupljenosti (član 5.1.2., 9. Osnovni principi državne službe). Isti zakon dalje propisuje: *u okviru državne službe u institucijama centralnog nivoa, najmanje 10% pozicija treba da bude rezervisano za osobe koje pripadaju zajednicama koje ne pripadaju većinskom stanovništvu na Kosovu i koje ispunjavaju specifične kriterijume zapošljavanja. Na opštinskom nivou za kvalifikovane članove zajednice koji nisu većinski u opštini, broj rezervisanih radnih mesta biće u skladu sa procentom zastupljenosti zajednica u datoj opštini.*³⁹

Pored toga, kabinet vlade je 3^{eg} septembra 2018 godine odobrio tri nacrt zakona koji su već identifikovani kao važni za proces reforme javne uprave. Nacrt zakona o platama u javnom sektoru, nacrt zakona o javnim službenicima i nacrt zakona o Organizaciji Državne Uprave i nezavisnih agencija su pripremljeni i očekuje se da regulišu funkcionisanje i organizaciju javne uprave na Kosovu.⁴⁰

Na opštinskom nivou zastupljenost zajednica u lokalnoj upravi se dalje reguliše *Zakonom o lokalnoj samoupravi Br. 03/L-040 (članovi 53., 54. i 55).*

Konačno, sekundarno zakonodavstvo uključuje mnoge dodatne propise sa specifičnijim odredbama koje se odnose na zastupljenost zajednica u vođenju javnih poslova, kao što je, između ostalog, Uredba 4/2010 o proporcionalnoj zastupljenosti zajednica, Ministarstvu javne uprave i Uredbi br. 02/2010 Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak.

³⁸Član 61, Zastupljenost među Zaposlenima u Javnim Institucijama, Ustav Kosova

³⁹ Član 11.3., Prijem u državnu službu, Zakon o državnoj službi, No.03/L-149, 13 May, 2010.

⁴⁰<http://kryeministri-ks.net/en/government-of-kosovo-approved-the-draft-law-on-salaries/>

Na osnovu nalaza predstavljenih u izveštaju OEBS-a o zastupljenosti zajednica u državnoj službi na Kosovu od maja 2017 godine, još uvek postoje nesporazumi među institucijama na centralnom nivou o tome da li treba poštovati zakonsku odredbu kojom se predviđa zastupljenost od 10 procenata, što je garantovano od strane kosovskog zakonodavstva za zastupanje zajednica, na način da bi ta odredba trebala biti sprovedena od strane svake institucije na centralnom nivou posebno ili se ta odredba odnosi na sveukupnu zastupljenost zajednica među svim institucijama na centralnom nivou.⁴¹

Očekuje se da se ovo pitanje prevaziđe novim predloženim Zakonom o javnim službenicima koji će ukinuti zakon o državnoj službi br. 03 / L –149⁴². Nacrt zakona o javnim funkcionerima uspostavlja pravni okvir za zapošljavanje javnih službenika u kosovskim institucijama na osnovu zasluga, moralnog integriteta, nepristrasnosti i održivosti.

Nacrt zakona o javnim funkcionerima predviđa sledeće: u centralnim javnim institucijama, najmanje deset procenata (10%) radnih mesta u svim kategorijama javnih službenika treba da popune članovi nevećinskih zajednica na Kosovu i koji ispunjavaju uslove za prijem , dok će na opštinskom nivou ispunjenje broja radnih mesta za članove zajednica biti u skladu sa procentom stanovništva u toj opštini.⁴³

II. Opis problema

Izveštaj OEBS-a o Zastupljenosti Zajednica u Državnim Službama na Kosovu od maja 2017 godine dalje ocenjuje da ukupan procenat zastupljenosti zajednica u javnoj upravi na centralnom nivou (18 institucija na centralnom nivou - predmet procene) ne dostiže 10 procenata . U decembru 2015 godine iznosio je 9,63%⁴⁴. Međutim, ova cifra nije doživela značajan porast u odnosu na 7,85% u 2013 godini, OEBS.⁴⁵ Pored toga, procenat zastupljenosti zajednica razlikuje se od institucije do institucije. Ministarstvo za zajednice i povratak je izuzetak, a nivo zastupljenosti zajednica je oko 45%⁴⁶, dok je zastupljenost zajednica u većini institucija na centralnom nivou još uvek ispod 10 procenata.

⁴¹ Zastupljenost zajednica u državnim službama na Kosovu, OEBS, maj 2017 godine, stranica .11.

⁴² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>

⁴³ Član 9, Predstavljanje zajednica, Nacrt zakona o javnim službenicima

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Predstavljanje zajednica, Nacrt zakona o javnim službenicima na Kosovu, OSCE, 2013 godine.

⁴⁶ Zastupljenost zajednica u državnim službama na Kosovu, OSCE, maj 2017 godine, stranica.11.

Pored toga, činjenica da većina institucija nema sistematski pristup u obezbeđivanju i objavljivanju ovih podataka, sa sobom nosi još jednu perspektivu problemu praćenja primene postojećeg zakonodavstva u pogledu zastupljenosti zajednica u javnim službama.

Nalazi iz različitih međunarodnih i lokalnih organizacija / institucija pokazuju da zajednice nisu dovoljno zastupljene u javnoj upravi u većini opština na Kosovu, a posebno kada je procena urađena za pojedinačno učešće svake od zajednica koje žive u dotičnoj opštini.

Zastupljenost zajednica u javnoj upravi na opštinskom nivou sprovodi se kroz druge mehanizme koji su predviđeni Zakonom o lokalnoj samoupravi, kao što je zamenik gradonačelnika za zajednice, zamenik predsednika Skupštine opštine za zajednice i opštinski odbor za zajednice. Iako mehanizmi za implementaciju predstavljanja zajednica na opštinskom nivou daju posebne kvote za manjinske zajednice na osnovu procenta stanovnika manjinskih zajednica, oni ne odražavaju nužno stvarnu situaciju jer se zasnivaju na statističkim podacima dobijenim najnovijim popisom stanovništva čije je sprovođenje srpska zajednica bojkotovala.

Okvirne preporuke

Uzimajući u obzir značaj pouzdanih podataka za praćenje implementacije postojećeg zakonodavstva u pogledu zastupljenosti zajednica u javnoj upravi, može se zaključiti da dodatne procene, više strukturalne i strateški preduzete da pokriju širi spektar institucija na oba nivoa, na centralnom i na opštinskom nivou su visoko preporučene i neophodne. To se više zasniva na činjenici da postojeće analize ne odražavaju pravo stanje u svim institucijama, već u ograničen broj analiziranih institucija i ne uključuju procenu javnih preduzeća na svim nivoima.

Dalja preporuka se odnosi na neophodna poboljšanja u vezi sa uspostavljanjem sistematičnijeg pristupa u pribavljanju i davanju podataka od strane javnih institucija, koje će omogućiti efikasnije praćenje primene postojećeg zakonodavstva u pogledu zastupljenosti zajednica u javnim poslovima.

Hyrje

Disa vitet e fundit në Kosovë kanë sjellë një sërë zhvillimesh që kanë shkaktuar ndryshime thelbësore në dinamikën e saj politike të brendshme dhe të jashtme. Këto ndryshime, që kanë implikime të gjera për të ardhmen e rajonit, janë shkaktuar nga ngjarje të tilla si zvarritja e procesit të dialogut, dhuna e motivuar politikisht në veri të Kosovës dhe mungesa e vazhdueshme e transparencës e shprehur nga përfaqësuesit politikë të Komuniteteve të ndryshme të Kosovës. Hollimi i procesit të dialogut, që veçse ishte i paqartë dhe i paprekshëm për shumë qytetarë të Kosovës, ka krijuar një situatë që është e mbushur me spekulime dhe shqetësime të përhapura për të ardhmen e shumë prej komuniteteve joshumicë të Kosovës. Rritja e diskutimeve për ndarje si një zgjidhje potenciale e qëndrueshme dhe afatgjatë për çështjen e statusit të Kosovës ka krijuar shqetësim të madh sa i përket aftësisë së akterëve dhe institucioneve politike për të siguruar mekanizma të mjaftueshëm për të mbrojtur të drejtat kushtetuese që i janë siguruar minoriteteve. Për më tepër, procesi i përgjithshëm i dialogut, deri më tani, kryesisht ka dështuar të zbut shqetësimet mbi mungesën e dukshme të vullnetit politik nga ana e akterëve institucionalë të Kosovës për të zbatuar në mënyrë efektive dhe në mënyrë të barabartë legjislacionin që është hartuar për të mbrojtur të drejtat e pakicave. Megjithëse kuadri ligjor, siç ekziston në letër, mund të përshkruhet përgjithësisht si progresiv në atë që i jep minoriteteve jo vetëm një tërësi të të drejtave, por edhe një shkallë autonomie në qeverisjen e çështjeve të komunitetit, zbatimi i tij aktual në përditshmëri thënë më së buti është e çrregullt. Bashkimi i të gjithë këtyre faktorëve të ndryshëm ka çuar në një atmosferë të përgjithshme paqartësie dhe mungese të dukshme të besimit institucional që këto institucione janë të gatshme ose të afta të ofrojnë mbrojtje efektive për komunitetet jo-shumicë.

Në rrethana të tilla është urgjentisht e nevojshme një analizë e hollësishme e çështjeve të përmendura më lart për të hedhur dritë mbi çështje të ndryshme që prekin komunitetin serb të Kosovës. Duke pasur parasysh këtë, qëllimi kryesor i raportit është marrja parasysh e pikëpamjeve të atyre që janë të angazhuar drejtpërdrejtë në këto çështje me qëllim që të sigurohen informata pëmbajtëse mbi këto tema. Kjo u arrit me angazhimin e organizatave të ndryshme të shoqërisë civile në procesin e hartimit me qëllim të shfrytëzimit të fushave të tyre të ndryshme dhe specifike të ekspertizës dhe mbulimit gjeografik. Në këtë frymë, anëtarët e organizatave joqeveritare kanë bërë një përpjekje të përbashkët me qëllim shkrimin të këtij raporti si mjet për të krijuar një mekanizëm monitorimi të qëndrueshëm dhe objektiv në lidhje me të drejtat e pakicave në Kosovë. Logjika mbizotëruese e kësaj është se një mekanizëm i tillë është i domosdoshëm për shkak të ndryshimeve socio-politike të shpejta dhe të paparashikueshme dhe efektin e tyre potencial mbi të ardhmen e të drejtave të pakicave si koncept ligjor dhe kushtetues në Kosovë. Duke pasur parasysh këtë, ky raport është hartuar duke pasur fokus kritik në çështjet që janë të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb dhe komunitetet tjera jo-shumicë në Kosovë dhe për mirëqenien e ardhshme ekonomike, politike dhe kulturore dhe ruajtjen e tyre.

Këshilli Konsultativ për Komunitete

I. Konteksti dhe përshkrimi i problemit

Këshilli Konsultativ për Komunitete është pjesë e Zyrës së Presidentit të Kosovës dhe përbëhet nga njëzet e shtatë anëtarë. Këshilli merr vendime të pavarura nga Zyra e Presidentit, të cilat nuk pasqyrojnë qëndrimin e tij. Roli i këtij organi është promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe me rekomandimet e veta të ju tërheq vërejtjen autoriteteve ekzekutive për shkelje të ligjit. Këshilli u formua zyrtarisht me dekret të Presidentit të Kosovës më 15 shtator 2008¹, ndërsa seancën e vet inauguruese e mbajti në fund të po atij viti. Përbëhet nga përfaqësues të komunitetit serb, boshnjak, turk, malazez, kroat, egjiptian, ashkali, rom dhe goran.

Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin sigurimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt të mendimeve ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës. Përgjegjësia e këtij organi është të ndihmojë në organizimin dhe artikullimin e qëndrimeve të komuniteteve jo-shumicë dhe pjesëtarëve të tyre kur bëhet fjalë për legjislacionin, politikat publike dhe programet me rëndësi të veçantë për ta. Këshilli përbëhet kryesisht nga anëtarë të sektorit joqeveritar të zgjedhur nga komuniteti i tyre jo-shumicë (ligji parashikon që, në një numër të caktuar, mund të zgjidhen edhe deputetët), si dhe nga tre përfaqësues të emëruar nga Qeveria e Kosovës dhe një përfaqësues i emëruar nga Zyra e Presidentit të Kosovës.

Ashtu si shumë organe të tjera në Kosovë edhe Këshilli Konsultativ për Komunitete është menduar dhe formuluar shumë mirë në pjesën ligjvënëse, në bazë të shembujve të legjislacioneve paralele, por në anën tjetër, në praktikë, tregon shumë mangësi dhe probleme. Këshilli nuk e përmbush plotësisht mandatin e vet, në radhë të parë, humb mundësinë për të qenë organi kyç për mbrojtjen e të drejtave, organizimin dhe artikullimin e qëndrimeve të komuniteteve jo-shumicë, arsyet për këtë janë të shumta, teknike, personale, organizative, financiare etj.

¹Këshilli Konsultativ për Komunitete është organ kushtetues, më saktësisht është formuar në bazë të Kushtetutës së Kosovës, Neni 60, si dhe në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, Neni 12. (Ligji për komunitetet).

Si mangësi themelore e Këshillit, mund të thuhet se anëtarët e Këshillit nuk shfrytëzojnë mundësinë për të marrë pjesë në fazat më të hershme në iniciativat në kuadër të procedurave legjislative ose politikave të përgatitura nga Qeveria apo Kuvendi, respektivisht në projekt ligjet dhe politika nuk jep rekomandime për përfaqësim më të mirë të komuniteteve jo-shumicë. Gjatë vitit 2018, përkundër faktit se Këshilli kishte pranuar të gjitha ligjet e kërkuara, Këshilli nuk dërgoi asnjë koment apo rekomandim për plotësime ose ndryshime të ligjeve dhe politikave të propozuara².

Si diçka shumë pozitive, e njëkohësisht suksesi më i madh i Këshillit në vitin 2018, duhet të theksohet se Këshilli inicioi fillimin e hartimit të Ligjit të ri për Komunitete³. Me iniciativën e Këshillit, Zyra e Presidentit mori përsipër hartimin e ligjit të ri dhe në vitin 2019 Këshilli planifikon të marrë një rol shumë aktiv në hartimin e këtij akti shumë të rëndësishëm për komunitetet jo-shumicë. Për fat të keq, kjo ishte iniciativa e vetme në vitin 2018, prandaj mund të konstatohet se Këshilli nuk nisi numër të mjaftueshëm iniciativash gjatë vitit 2018. Duhet gjithashtu të theksohet se ka komunikim shumë të dobët të anëtarëve të Këshillit me përfaqësuesit e komuniteteve që ata përfaqësojnë dhe se informacioni mbi punën e Këshillit ende mbetet shumë i ulët. Mungesa e aktiviteteve në teren lidhur me komunitetet që ata përfaqësojnë, si dhe mungesa e takimeve të rregullta konsultative, është arsyeja kryesore për informimin e dobët dhe komunikimin e dobët me komunitetet të cilat anëtarët e Këshillit i përfaqësojnë. Mangësitë buxhetore janë arsyeja kryesore për mungesën e aktiviteteve të tilla.

Këshilli Konsultativ për Komunitete ka përmbushur rolin e funksionimit si një forum për koordinim dhe këshillim ndërmjet komuniteteve, por për shkak të mungesës së iniciativave dhe aktiviteteve specifike (për shkak të buxhetit të vogël), Këshilli ka problem të paraqesë punën e vet në mënyrë të duhur dhe të forcojë pozitën e vet në mesin e komuniteteve jo-shumicë.

Siç është theksuar më sipër, Këshilli përballlet me shumë probleme teknike dhe organizative. Problemi i parë del të jetë mungesa e interesit të komuniteteve dhe institucioneve të caktuara për punën e Këshillit. Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, të mbajtura në vitin 2018, nga komuniteti serb janë akredituar 16 organizata, nga të cilat vetëm një është nga katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës⁴. Kjo paraqet rritje të numrit të organizatave

²<http://www.ccc-rks.net/index.php/sr/aktivnosti/godisnji-izvestaj-rada-meny>

³<http://www.ccc-rks.net/images/stories/Dokumente/Ligjet/Izmene.zajednice.pdf>

⁴<http://www.ccc-rks.net/index.php/sr/onama/clanovi-svz-a-2016-2018>

krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, por një numër i madh i organizatave të rëndësishme ende nuk merr pjesë. Bashkëpunimi me institucionet nuk është në nivel mjaft të lartë. Këshilli i ri u formua në tetor 2018, ndërsa deri më sot (mars 2019), Qeveria nuk i emëroi përfaqësuesit e vet në Këshill.

Një problem tjetër është ekspertiza dhe përkushtimi i anëtarëve të Këshillit, ku secili komunitet duhet të zgjedh anëtarët më profesional në Këshill, por ka probleme të caktuara, kryesisht lidhur me kohëzgjatjen e mandatit. Mandati i anëtarëve të Këshillit është 2 vjet, me mundësi rizgjedhje deri në maksimum prej 2 vjetësh, ndërsa një mandat i fillë i shkurtë hap disa probleme praktike, kryesisht për komunitetet më të vogla që nuk kanë kuadro profesionale që mund të plotësojnë kërkesat dhe të jenë anëtarë produktiv. Nga ana tjetër, kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit janë mjaft të gjera, prandaj anëtarët e Këshillit janë praktikisht persona që kanë vullnet për të ndihmuar komunitetin e tyre, por iu mungon ekspertiza për ta artikuluar këtë në mënyrë adekuate dhe efikase.

Problemi tjetër është buxheti me të cilin disponon Këshilli. Gjatë vitit 2018 Këshilli kishte në dispozicion një buxhet vjetor prej 47.000 euro⁵⁶. Për një trup i cili është kategori kushtetuese dhe i cili do të duhej të ishte një nga mekanizmat kryesor për mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë dhe përmirësimin e pozitës së tyre, këto mjete janë shumë të vogla. Anëtarët e Këshillit marrin një kompensim për punën e tyre në Këshill (mëditjet), por ky kompensim është i vogël dhe nuk lejon që anëtarët e Këshillit t'i përkushtohen plotësisht punës në Këshill. Për shkak të buxhetit të vogël, anëtarët e Këshillit nuk janë në gjendje të bëjnë më shumë punë në teren dhe të kenë kontakte më të mira me përfaqësuesit e komuniteteve të tyre. Buxheti për vitin 2019 është rritur, por është ende i ulët për trupin e këtij karakteri⁷.

Si një gjë pozitive, duhet të theksohet fakti se në zgjedhjet për përbërjen e re të Këshillit në vitin 2018, në Këshill u përzgjodh pothuajse një numër i barabartë i grave dhe burrave (nga 23 anëtarë të zgjedhur, 11 gra)⁸, gjë që nuk ishte rasti me përbërjet e mëparshme. Fakti që aktualisht është në proces hartimi i legjislacionit të ri për komunitete, i cili në një pjesë do të rregullojë edhe punën e

⁵<http://www.ccc-rks.net/>

⁶Kjo shumë shërben për të mbuluar shpenzimet e punës së Sekretariatit, si dhe për të mbuluar shpenzimet dhe aktivitetet e Këshillit.

⁷<http://www.ccc-rks.net/>

⁸<http://www.ccc-rks.net/index.php/sr/onama/clanovi-svz-a-2016-2018>

Këshillit Konsultativ, duhet të shfrytëzohet ky moment për të përmirësuar efikasitetin e Këshillit.

Rekomandimet

- Gjëja e parë në të cilën duhet insistuar është zgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit dhe rritja e numrit të mandateve të lejuara, që do rriste efikasitetin dhe produktivitetin e Këshillit duke krijuar mundësinë që anëtarët e Këshillit të jenë pjesëtarët më të përkushtuar të komunitetit të tyre. Gjithashtu, trajnimet të cilat i vijnë anëtarët e rinj të Këshillit duhet të mbahen para përfshirjes së tyre në punën e Këshillit, në mënyrë që ata të bëhen anëtar funksional menjëherë pas emërimit zyrtar.
- Duhet të ndërmerren aktivitete për të rritur numrin e organizatave dhe shoqatave të akredituara, e në këtë mënyrë të sigurohet që Këshilli të ketë përbërjen sa më cilësore. Kjo duhet të arrihet përmes aktiviteteve të promovimit dhe informimit gjatë procesit të akreditimit të shoqatave dhe organizatave.
- Me zgjatjen e mandatit duhet të ashpërsohen kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të rinj, veçanërisht në fushën e aftësive profesionale, sepse shprehja e vullnetit të mirë për trajtimin e çështjeve të caktuara lidhur me komunitetin e tyre nuk mjafton, por është e nevojshme të dëshmohet ekspertiza e mjaftueshme për t'u marrë me këto çështje. Me këtë do të emëroheshin kuadro më profesionale në Këshill, i cili do të ketë mundësi të veprojë për një periudhë më të gjatë nëpërmjet punës së Këshillit.
- Duhet të sigurohen mjete për anëtarët e Këshillit për të pasur konsultime të rregullta me përfaqësuesit e komuniteteve të tyre, gjë që do të rriste dukshmërinë dhe informimin më të mirë të anëtarëve të Këshillit për problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti.
- Mjetet e parapara për punën e Këshillit duhet të rriten ndjeshëm, qoftë përmes buxhetit të Këshillit ose nëpërmjet donacioneve. Anëtarëve të Këshillit duhet t'u ofrohet mundësia që të jenë më të përkushtuar ndaj punës së Këshillit dhe në kontaktet me komunitetin që ata përfaqësojnë duke iu rritur kompensimin. Me këtë do të rritet produktiviteti dhe efikasiteti i Këshillit dhe do të rritet numri i personave të interesuar për të marrë pjesë në punën e këtij trupi.
- Është e nevojshme të rritet numri i aktiviteteve konkrete që Këshilli zbaton në zgjidhjen e problemeve të caktuara për të promovuar punën e këtij trupi dhe për të përmirësuar statusin e të gjitha komuniteteve në një mënyrë të caktuar.

Të drejtat e komuniteteve dhe e drejta në kthim

I. Konteksti dhe përshkrimi i problemit

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Etnike ka përcaktuar bazën ligjore për respektimin e të drejtave të pakicave, të cilën, ndër të tjera, e ka nënshkruar edhe Kosova. Korniza ligjore e Kosovës mbështetet mu në këtë kornizë ndërkombëtare dhe mbi themelet e praktikës së zakonshme juridike ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave janë përcaktuar këto mjete juridike:

- Ligji Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i miratuar më 13 mars 2008
- Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, i miratuar më 27 korrik 2006,
- Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar, i miratuar më 31 gusht 2011,
- Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Kosovës, i miratuar më 15 qershor 2008
- Ligji nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, i miratuar më 9 tetor 2006.
- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.

Të gjithë mekanizmat ligjor të lartpërmendur në Kosovë janë miratuar me qëllim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve jo-shumicë dhe zhvillimit të tyre në jetën shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Megjithatë, zbatimi i ligjeve të sipërpërmendura të Kosovës shpesh është në kundërshtim me praktikën në terren. Megjithëse korniza institucionale dhe ligjore është përcaktuar në mënyrë adekuate dhe është përshtatur me nevojat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, zbatimi i ligjeve është i dobët dhe shpesh varet nga ndërhyrjet e bashkësisë ndërkombëtare. Përveç kësaj, komunikimi dhe koordinimi joadekuat ndërmjet nivelit lokal dhe qendror lidhur me zbatimin e ligjeve edhe më shumë e ndërlikon fuqizimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

Sa i përket të dhënave statistikore, e në lidhje me përfaqësimin e përfaqësuesve të komuniteteve pakicë në administratën publike në nivel qendror, Ligji për zyrtarët shtetëror të Kosovës parashikon një prag prej minimum 10% i rezervuar për punësimin e përfaqësuesve të komuniteteve jo-shumicë. Për fat të keq, në shumë raste kjo kuotë nuk është zbatuar në praktikë dhe Ligji nuk është zbatuar

plotësisht, që do të thotë se nuk ka respektim të plotë për të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Në këtë kuptim nevojitet përfshirja më e madhe e Zyrës për Çështje të Komuniteteve, e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë në Kosovë. Për shkak të rishpërndarjes joadekuate të burimeve financiare për të gjitha komunitetet jo-shumicë, është gjithashtu e nevojshme të rritet angazhimi, por edhe përgjegjësia e Zyrës për Çështje të Komuniteteve. Strategjitë publike të miratuara me qëllim të mbështetjes financiare dhe logjistike për komunitetet në Kosovë nuk zbatohen brenda kornizës së përcaktuar kohore, gjë që gjithashtu ndërlikon procesin e përmirësimit të standardeve të respektimit të të drejtave të pakicave.

Duke marrë parasysh faktin se ka një hendek midis politikave praktike në nivelin qendror të qeverisë dhe zbatimin e tyre në nivel lokal⁹, të drejtat e komuniteteve pakicë në Kosovë nuk respektohen plotësisht për arsye administrative, si dhe për shkak të mungesës së informimit të stafit të punësuar në institucionet publike. Në rastin e këtij hendeku nuk ekziston ndonjë procedurë kontrolluese me të cilën do të procedohej (më shumë) shkelja e të drejtave të komunitetit. Gjithashtu, nuk ekziston një dialog social i përshtatshëm për përfshirjen e grupeve më të cenuara shoqërore, duke përfshirë komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali. Këshilli Konsultativ për Komunitete¹⁰ duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces, anëtarët e të cilit ishin aktiv deri tani, por pa ndonjë ndikim efektiv në Qeveri në fushën e zbatimit të ligjeve ose politikave praktike në lidhje me komunitetet pakicë në Kosovë.

Nga ana tjetër, projekti i mbështetur nga Këshilli i Evropës - ROMACTED¹¹ ka kontribuar në nivel lokal në përmirësimin e gjendjes në fushën e politikës gjithëpërfshirëse. Përmes këtij programi pjesëtarët e komunitetit rom janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Megjithatë, ky shembull i një strategjie të mirë e gjithëpërfshirëse përsëri shpërfaq problemin i cili krijohet nga fakti se përparimi në respektimin dhe përfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë është adekuat vetëm nëse ka mbështetje nga institucionet ndërkombëtare.

⁹<https://www.coe.int/en/web/portal/home>

¹⁰<https://www.president-ksgov.net/en/consultative-council-for-communities>

¹¹<https://www.coe.int/en/web/tirana/romacted-promoting-good-governance-and-roma-empowerment-at-local-level>

Në lidhje të ngushtë me çështjen e respektimit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë është edhe e drejta e personave të zhvendosur në kthim. Në veri të Kosovës, sipas disa vlerësimeve, ende jetojnë 6.859 serbë të Kosovës të zhvendosur brenda vendit, ndërsa 6.951 shqiptar të Kosovës të zhvendosur brenda vendit, jetojnë në rajonin e Mitrovicës së Jugut¹². Sa i përket personave të zhvendosur brenda vendit të kombësisë Serbe nga regjioni i Prishtinës, ata kryesisht janë të vendosur në Graçanicë dhe fshatrat përreth. Pjesa e mbetur e serbëve të Kosovës të zhvendosur brenda vendit gjendet në regjionin e Gjilanit dhe në strehimoret kolektive në komunën e Shtërpçës. Procesi i kthimit të personave të zhvendosur nga të gjitha kombësitë shkon shumë ngadalë dhe varet nga disa faktorë. Në radhë të parë, ende ekziston paqëndrueshmëria politike në Kosovë, marrëdhëniet e pazgjidhura ndëretnike dhe një proces i ngadalshëm i pajfimit, si dhe zbatimi jo adekuat i masave të Qeverisë për kthimin e personave të zhvendosur. Duhet të shtohet se edhe sulmet e shpeshta ndaj familjeve të kthyer (sidomos në zonën e Kosovës perëndimore dhe Anamoravës) pengojnë mbijetesën e të kthyerve në vatrat e tyre. Pasi të merren parasysh të gjitha problemet e lartpërmendura, është e qartë se ka një numër pengesash që pengojnë kthimin e personave të zhvendosur në territorin e Kosovës së pasluftës. Tensionet e shpeshta politike midis Beogradit dhe Prishtinës, si dhe prania e një numri të caktuar të incidenteve ndëretnike në përgjithësi ngadalësojnë kthimin e domosdoshëm të personave të zhvendosur.

Duke pasur parasysh faktin se në vitin 2018 vetëm 232 pjesëtarë të komuniteteve pakicë¹³ janë kthyer vullnetarisht në Kosovë, që paraqet nivelin më ultë në tetëmbëdhjetë vitet e fundit, vërehet se situata është mjaft alarmante. Personat e zhvendosur të cilët u kthyen vullnetarisht mbetën nën ndikimin e disa faktorëve, mes të cilave më të rëndësishme janë mjedisi i vështirë politik dhe ekonomik, si dhe mungesa e personave të zhvendosur nga vendet e tyre amë për një periudhë të gjatë kohore, gjë që iu ka vështirësuar përshtatjen me kushtet e vendit. Përkundër faktit se autoritetet lokale dhe qendrore janë përpjekur të theksojnë rëndësinë e kthimit të personave të zhvendosur, me hapa konkretë të ndërmarrë për të mbështetur procesin e kthimit, komunat nuk ia kanë dalë t'i përgjigjen sfidave afatgjata në trajtimin e problemeve me të cilët ballafaqohen personat e zhvendosur. Thelbi i kësaj qasjeje joefektive qëndron në mungesën e burimeve financiare dhe burimeve të tjera logjistike dhe administrative.

¹²UNHCR Statistical Overview – tetor 2018

¹³UNHCR Statistical Overview – tetor 2018

Si një nga çështjet më urgjente, sidomos kur është fjala për të kthyerit e kombësisë rome, egjiptiane dhe ashkali është se shpesh ka probleme procedurale dhe administrative në marrjen e dokumenteve të Kosovës, si dhe konfirmimin e statusit të personit të zhvendosur. Përveç kësaj, këto komunitete, bashkë me atë serbe, shpesh janë viktima të incidenteve sporadike, kryesisht vjedhjeve, të cilat fatkeqësisht nuk janë ndjekur nga policia dhe autoritetet gjyqësore. Uzurpimi i pronës private, kryesisht të asaj në zonat urbane, ende paraqet një problem të madh për të gjitha komunitetet (e kthyerat) në Kosovë.

Përfshirja e institucioneve ndërkombëtare (UNHCR), organizatave joqeveritare të Kosovës dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në kthimin e personave të zhvendosur shpesh krijon konflikte të ndërsjella, në kuptim të përgjegjësisë dhe kompetencës. Mungesa e komunikimit cilësor midis këtyre subjekteve, si dhe të tyre me institucionet lokale, e vështirëson punën e përbashkët për kthimin e personave të zhvendosur.

Rekomandimet

- Është e nevojshme të respektohet pragu minimal prej 10% për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, me qëllim të ndikimit të tyre në politikat lokale dhe qendrore.
- Zyrat, bordet dhe trupat tjerë duhet të angazhohen në mënyrë më transparente dhe më aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë.
- Rritja e mbështetjes financiare dhe logjistike është një faktor kyç që do të rrisë aftësinë e përfaqësuesve të komuniteteve jo-shumicë për të mbrojtur të drejtat e komunitetit të cilit i përkasin.
- Çdo rast i diskriminimit duhet të paraqitet në media, me masa adekuate shoqëruese juridike që synojnë luftimin e diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të pakicave.
- Është e domosdoshme të forcohen fushatat informuese që synojnë personat e zhvendosur, me qëllim të ofrimit të informatave të vërteta dhe të dobishme për numër sa më të madh të këtyre komuniteteve.
- Organizatat ndërkombëtare duhet të monitorojnë dobësitë e institucioneve të Kosovës dhe t'i informojnë ato menjëherë për edhe t'i këshillojnë për hapat e mëtejshëm.
- Organizatat joqeveritare lokale duhet të angazhohen në fushën e mbrojtjes së të drejtës për kthim dhe në ofrimin e ndihmës personave të zhvendosur, të cilëve me të vërtetë iu nevojitet ndihma. OJQ-të e

themeluara nga komunitetet jo-shumicë duhet të jenë më të dukshme dhe më aktive.

- Forcimi i kapacitetit të stafit në vetëqeverisjet lokale duhet të bëhet prioritet i Qeverisë së Kosovës. Me një proces adekuat të mbështetjes dhe trajnimit, administrata publike mund të trajnohet dhe informohet për rëndësinë dhe procedurat në fushën e të drejtave të komuniteteve dhe të drejtës në kthim. Organizatat ndërkombëtare si UNHCR dhe OSBE mund ta mbështesin këtë proces.
- Ekziston nevoja për një mbështetje më të gjerë dhe më serioze të forcave të policisë së Kosovës dhe autoriteteve të gjyqësorit në mbrojtjen e të kthyerve për shkak të rrezikimit të shpeshtë dhe të gjithanshëm të sigurisë dhe pronës së tyre.

Largimi i heshtur

Kur është fjala për të drejtat themelore të njeriut, e në veçanti të drejtat kolektive politike të komuniteteve, respektivisht të drejtat e komuniteteve jo-shumicë, është jashtëzakonisht e rëndësishme të merret parasysh komponenti i tyre praktik, operativ. Koncepti dhe idetë e të drejtave themelore të njeriut dhe të “gjeneratës” së drejtave të tjera: politike, sociale, fetare, kulturore, seksuale, nuk paraqesin vetëm një koncept ideor-filozofik dhe një paradigmë humaniste-filantropike. Të drejtat duhet të kenë komponentin e tyre përshkruese, d.m.th. duhet të jenë të kodifikuara nga kushtetuta dhe ligjet që rrjedhin nga shkronja dhe fryma e asaj kushtetute si akti më i lartë ligjor. Por kjo është vetëm një parakusht. Këto ligje, me të cilat garantojnë të drejtat, duhet të zbatohen në terren në mënyrë themelore.

Megjithatë, ekziston edhe një element i tretë, i cili në kontekstin e Kosovës, e në veçanti të komunitetet jo-shumicë, respektivisht rezultati thelbësor i atyre të drejtave të garantuara me ligje dhe kushtetutë. Si ndikojnë të drejtat në jetën e një komuniteti, familjeje, individi? Kjo është pyetja kryesore, kjo është tema në Kosovë kur bëhet fjalë për të drejtat e komunitetit. Sa i përket elementit të tretë të së drejtave, efektit të tyre, duhet t'i kushtohet vëmendje mjedisit dhe të gjithë faktorëve relevantë që mund të ndikojnë nëse të drejtat ushtrohen fare dhe, nëse ato realizohen, cili është dimension i sasior dhe cilësor i efektit të tyre. Ky mjedis përbën një kontekst më të gjerë shoqëror-politik, që nga sistemi juridik

dhe politik, sistemi ekonomik dhe social, mjedisi i sigurisë deri në kontekstin shoqëror-kulturor në të cilin të drejtat e caktuara duhet të kenë implikime konkrete. Si tregues themelor metodologjik që ka problem me komunitetin serb në fushën e realizimit të të drejtave të garantuara dhe dimensionit cilësor i efektit të së drejtës, i cili është kompleks dhe shumëdimensional, është "largimi i heshtur" i serbëve nga Kosova, me një fokus të veçantë në largimin e të rinjve.

Përveç faktit që asnjë subjekt politik dhe shoqëror në Prishtinë apo Beograd, e as në nivel ndërkombëtar, të paktën zyrtarisht, nuk zotëron statistika relevante dhe metodologjike të besueshme për numrin e komunitetit serb në Kosovë me fokus në migrimin e tij që nga qershori i vitit 1999, është e pamundur për të mos vënë re trendin afatgjatë të emigrimit të serbëve nga Kosova që nga qershori i vitit 1999. Gjithsesi duhet të theksohet se një nga arsyet themelore pse sot nuk ka të dhëna relevante për numrin e komunitetit serb paraqet edhe fakti i bojkotit të pjesshëm të regjistrimit të popullsisë në Kosovës në vitin 2011 nga ana e komunitetit serb¹⁴. Përlllogaritjet e numrit, të përafërta dhe metodologjike, pa dyshim të pabazuara, bëhen në bazë të regjistrimit në regjistrin civil dhe në listën e votuesve në Kosovë¹⁵. Këto burime ndoshta mund të na japin disa informata bazë për numrin e banorëve, por jo edhe lidhur me numrin sa qytetarë janë larguar nga Kosova dhe nga cila kategori e popullsisë. Prandaj, analiza mund të bazohet vetëm në të dhënat bazë, por edhe në punën vetanake të OJQ-ve të caktuara në komunitet, si dhe në numrin relevant të intervistave me subjektet kyç social. Një tjetër sfidë e rëndësishme është përgjithësimi dhe prezenca gjithandej e kësaj teme në media dhe në diskursin publik gjatë viteve të fundit. Aq shumë flitet për këtë, formalisht dhe joformalisht, sa që fitohet përshtypja se gjithçka është pothuajse e njohur. Ky është pikërisht problemi hulumtues. Askush deri më tani nuk ka adresuar seriozisht dhe sistematikisht këtë çështje, çështjen e largimit të të rinjve, kryesisht të arsimuar, të cilët përfaqësojnë një kapacitet të rëndësishëm për komunitetin e tyre (demografik, intelektual, ekonomik, kulturor) nga Kosova.

Çka mund të përcaktohet nga një vëzhgim banal është tendenca e rritjes së migracionit, të grupit të caktuar të synuar, jashtë Kosovës, për dy arsye themelore:

1. Studimet;
2. Puna (arsye socio-ekonomike).

¹⁴https://www.b92.net/info/komentari.php?nav_id=504909

¹⁵<http://www.kqz-ks.org/Sr/sherbimet-per-votuesit/lista-votuese/>

Megjithatë, kur flasim për shkaqet e këtyre migrimëve, ato asesi nuk mund të redukohen vetëm në këto dy shkaqe, motivet e të rinjve për t'u larguar nga Kosova janë sigurisht jashtëzakonisht komplekse dhe shumëdimensionale.

Pohimi themelor i kësaj analize është se: konteksti socio-politik dhe kushtet socio-ekonomike janë një faktor i rrezikimit të të drejtave themelore të njeriut, si dhe të drejtave të veçanta kolektive dhe politike të komunitetit serb në Kosovë dhe se një nga treguesit më themelor, në të njëjtën kohë edhe të rëndësishëm për shoqërinë, është largimi i serbëve të rinj nga Kosova.

Parashtrohet pyetja cili është konteksti social dhe politik i cili në dekadën e fundit në Kosovë rezulton në largimin e të rinjve. Është e padiskutueshme që në Kosovë ekziston një trend i përgjithshëm i largimit të rinjve jashtë vendit, pavarësisht nga komuniteti etnik, ashtu si në të gjithë Ballkanin. Si ndodhi që serbët, përkundër gjoja garantimit të të drejtave të pakicave, të mos duan të vazhdojnë të jetojnë në Kosovë¹⁶? Përgjigja qëndron pikërisht në kontekstin politik dhe shoqëror në Kosovë. Ky kontekst është kompleks dhe përbëhet nga disa struktura shkatërruese, faktorë që ndikojnë negativisht në arritjen dhe cilësinë e të drejtave të realizuara pjesërisht për komunitetin serb në Kosovë. Ajo që është e rëndësishme për të gjithë shoqërinë kosovare është se këta faktorët janë të përgjithshëm dhe janë:

1. korrupsioni¹⁷;
2. nepotizmi;
3. partokracia;
4. ekstremizmi¹⁸;
5. varfëria¹⁹;
6. mungesa e sistemit të vetë-qëndrueshëm ekonomik;
7. mos konsolidimi i aparatit institucional;
8. çështje të pazgjidhura në fushën e drejtësisë tranzicionale;
9. mungesa e kohezionit social;
10. statusi i pazgjidhur politik;

¹⁶<https://www.radiokim.net/vesti/politika/srbi-imaju-naiveca-prava-od-svih-nevecinskih-zajednica-u-evropi.html>

¹⁷<https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-korupcija-specijalni-sud/29193492.html>

¹⁸https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_CaseStudy3_kosovo_SRB_40779_6.pdf

¹⁹<https://www.dw.com/sr/siroma%C5%A1tvo-na-kosovu/a-2737149>

Si rezultat i efektit shumëzues të këtyre strukturave shkatërruese, ekziston një proces i largimit të të rinjve nga Kosova. Gjatë shqyrtimit të të gjithë faktorëve negativë të paraqitur më lartë, një person i ri dhe i arsimuar (arsimi universitar dhe i lartë nuk janë kusht i domosdoshëm) nga Shtërpca, Shillova, Llaplasella, Osojani, Graçanica, Plemetini, Kllokoti, Leposaviqi ose Novobërda nuk mund të punësohet në sektorin publik (partokracia, nepotizmi, korrupsioni, problemet që dalin nga mosnjohja e gjuhës shqipe), nuk mund të zhvilloj biznesin e vet familjar, biznesin në mikro mjedise, çfarë edhe janë komunitetet në të cilat jetojnë dhe punojnë serbët në Kosovë, prandaj e vetmja dalje është vendimi për t'u larguar nga Kosova.

Në tekst tashmë është vënë në dukje se nuk ka të dhëna statistikore objektivist të bazuara metodologjike në të cilat mund të mbështetemi, prandaj analiza bazohet në një vlerësim të përafërt të ekipit hulumtues dhe në bazë të intervistave me udhëheqësit e fshatrave, drejtorët e institucioneve arsimore, të shkollave fillore dhe të mesme, drejtorët e institucioneve të kujdesit shëndetësor, primar dhe sekondar, dhe me klerin, të cilët, sipas të gjithë gjasave, janë të vetmit që posedojnë të dhëna të caktuara sasiore.

Numri i të rinjve që u larguan nga Kosova në drejtim të vendeve të Evropës Perëndimore, vetëm në regjionin e Gjilanit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Kllokotit, gjatë vitit të kaluar tejkalon 200 të rinj. Ky vlerësim nuk përfshin numrin e të rinjve që kanë shkuar për të studiuar në Mitrovicën e Veriut. Trendi i ri, i cili gjithashtu është fatal në aspektin e perspektivës demografike të komunitetit serb, është zvogëlimi i numrit të studentëve që zgjedhin të studiojnë në Mitrovicën e Veriut, por zgjedhin të ndjekin studimet e tyre në ndonjërin prej qendrave universitare në Serbinë qendrore, në Nish, Kragujevc, edhe pse çdo herë e më shumë edhe Beogradi bëhet zgjedhja e parë dhe e vetme.

Në Kosovën qendrore dhe rajonin e Shtërpcës, në veçanti komunat Graçanicës, me pjesë të komunave të Lipjanit, Fushë Kosovës, Prishtinës dhe Obiliqit, ku sipas vlerësimeve të përafërta jetojnë mbi 20.000 serb, dhe komunës së Shtërpcës, ku jetojnë deri në 10.000 serb, natyrisht me tendencë të zvogëlimit të popullsisë, përkundër natalitetit më së të kënaqshëm, tendenca e largimit të të rinjve ka veçoritë e veta. Sipas një vlerësimi të përafërt, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme statistikore, numri i të rinjve që u larguan nga Kosova, kryesisht për në Serbi qendrore, është deri në 200. Veçoritë e migrimit të të rinjve nga Kosova qendrore në raport me regjionin e Gjilanit ose në raport me komunën e Shtërpcës është se nga komuna e Graçanicës të rinjtë më vështirë

vendosin të migrojnë në Evropën Perëndimore, por zgjedhja e tyre e parë është ndonjëra nga qendrat e mëdha në Serbinë qendrore: Nishi, Beogradi, e çdo herë e më shumë edhe Novi Sadi, për shkak të zhvillimit ekonomik më dinamik të qytetit.

Sa i përket veriut të Kosovës në trendin e migracionit mund të konkludohet se gjendet diku ndërmjet veçorive të Kosovës qendrore dhe të regjionit të Gjilanit, ku një numër i madh migron në Serbinë qendrore, pos hiq më pak edhe jashtë vendit.

Kjo padyshim është trend i përgjithshëm në Kosovë, migrojnë edhe romët, shqiptarët, boshnjakët e rinj dhe jo vetëm serbët. Ky trend i përgjithshëm imponon që zgjidhja nuk mund të kërkohet pjesërisht nga komuniteti në komunitet, nga komuna në komunë, nga regjioni në regjion, por duhet të gjendet një zgjidhje e përbashkët dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë të rinjtë në Kosovë, sepse në të kundërtën, shumë më shpejt se sa qe kushdo në Kosovë e sheh dhe parashikon, e gjithë shoqëria kosovare do të gjej veten në një problem me të cilin ballafaqohet komuniteti serb, çështjen e mosekzistimit të së ardhmes.

Rekomandimet e përgjithshme:

- Të fuqizohet kapaciteti ekonomik i regjioneve më pak të zhvilluara të Kosovës.
- Të forcohet mbështetja financiare dhe logjistike për ndërmarrësit e rinj.
- Kthimi i fokusit të politikës së Kosovës nga kundërshtimet e përditshme politike drejt hapave konkretë për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike dhe për të forcuar perspektivën ekonomike.

Siguria

I Konteksti dhe përshkrimi i problemit

Kosova veriore ka paraqitur shumë dilema sigurie në epokën e pasluftës në Kosovë, për shkak të zhvillimit autentik të saj politik, kulturor dhe ekonomik. Për më tepër, fakti se veriu i Kosovës ka qenë dëshmitar i dualizmit institucional (institucioneve të kontrolluara nga Prishtina dhe Beogradi) dhe në harresë politike dhe ekonomike për një periudhë më të gjatë kohore (sidomos pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit), ka bërë që fotografia e përgjithshme të

jetë e paqartë dhe e komplikuar. Prandaj, një hendek i fillë i krijuar nga mungesa e mekanizmave të monitorimit të zbatuar plotësisht mbi Kosovën Veriore ka rezultuar në një ekzistencë të gjerë të nepotizmit dhe korrupsionit, të cilat kanë kufizuar ndjeshëm çfarëdo depërtimit të përfitimeve ekonomike dhe sociale.

Është e rëndësishme të theksohet se, rrjedhimisht, një vakum i fillë i sigurisë, i katalizuar nga fërkimi i dy pushteteve kundërshtarë dhe joefektive ekzekutive mbi Kosovën e Veriut, ka prodhuar krizë politike të vazhdueshme. Kështu, katër komuna në këtë rajon (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi) jo vetëm kanë ulur potencialet e tyre zhvillimore, por janë bërë edhe instrument i "tregtisë" politike ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, kryesisht për qëllime propagande (përdorimi të brendshëm). Ky problem i saktë është ndezur pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për vendosur tarifa 100% për importin e mallrave të prodhuara në Serbi. Si reagim ndaj një krize të re të krijuar, të katër kryetarët e komunave në katër komunat veriore kanë vendosur të tërheqin funksionet e tyre dhe kanë ndërprerë çfarëdo lidhje (ligjore/zyrtare) me autoritetet në Prishtinë. Që atëherë, vakumi politik dhe administrativ në veri është rënduar në mënyrë drastike. Në rrethana të tilla, lëvizjet e rrezikshme politike të bëra nga Prishtina zyrtare dhe liderët serb të Kosovës (veriore) (të mbështetur nga Beogradi zyrtar) kanë krijuar së bashku një krizë ekonomike dhe humanitare (mungesë të furnizimeve ushqimore dhe medikamenteve), që pati ndikim në të gjithë qytetarët e Kosovës, por sidomos ata që jetojnë në veri të Kosovës.

